

VENDIM
Nr.728, datë 1.7.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME,
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS LESKOVIK TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Leskovik të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 132 (njëqind e tridhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 906 (nëntëqind e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Leskovik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Leskovik

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive.	Në pronësi
4,5,10,18-19, 24,29,34,39,44,49,54,58,67	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
6,7,8,9,11-17,20-23,25-28, 30-33,35-38,40-43,45-48,50-53,55-57,59-66,68-71	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
79-93	Shërbim funeral	Në pronësi
94	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
95-105	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
106	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi

713-743	Infrastrukturë rrugore	Në pronësi
771-780	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi